



**N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.**  
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.  
e-mail.. [contact@pallatirinise.com](mailto:contact@pallatirinise.com)  
[www.pallatirinise.com](http://www.pallatirinise.com)

Në bazë të vendimit të miratuar me datën 28.04.2021 nga ana e Menaxhmentit të NPL PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë, e duke u bazuar në nenin nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, nenit 4 pika 1,2,3,4,5, nenit 5 të udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 6 të Rregullores së Punës, N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. – Prishtinë, U.d. Kryeshefi Ekzekutiv me datë 30.04.2021, **SHPALLË:**

## **KONKURSIN PUBLIK**

**I. Titulli i vendit të punës:** punëtor fizik të mirëmbajtjes higjienike në njësinë e ndërtimtarisë dhe mirëmbajtjes higjienike në Departamentin tekniko - higjienik (**4 punëtorë**);

**II. Numri i referencës: NPL –D.T. 30/04/21:**

**III. Detyrat dhe përgjegjësitë:**

Organizon, mbikëqyrë dhe përgjigjet për mirëmbajtjen e punëve dhe detyrave të punës e sidomos këtyre punëve:  
-kryen të gjitha punët fizike në nivel të, NPL “PALLATI I RINISË” SH.A. në Prishtinë  
-bënë bartjen e panove për programe të ndryshme në qendër dhe në qytet,  
-sjelljen dhe largimin e sendeve të ndryshme dhe të inventarit nga lokalet e NPL “PALLATI I RINISË” SH.A. në Prishtinë ,  
-bartjen, montimin dhe demontimin e ringut, tribunave, skelave të ndryshme hedhjen e mbeturinave,  
-pastrimin dhe mirëmbajtjen e lokaleve dhe hapësirave në objekt, lokalet e punës në qendër dhe në të gjitha sipërfaqet tjera, pastrimin e mureve, karrigeve, tavolinave dhe enterierit tjetër,  
-mirëmban pastërtinë e dyshemesë, tepihëve, larjen e dritareve, perdeve e tjera,  
-bënë pastrimin me mjete teknike të gjitha sipërfaqeve që mund të pastrohen në qendër e edhe me makinë thithëse, dhe u ndihmon punëtorëve tjerë në Departamentin e vet dhe në Departamente tjera lidhur me pastërtinë,  
- kryen edhe punë tjera me urdhëresën e para punëtorit, kryepunëtorit dhe udhëheqësit të njësisë – përgjegjësit të ndërtimtarisë dhe dhe mirëmbajtjes higjienike.

**IV. Kushtet për pjesëmarrje në procesin e rekrutimit**

- Kërkesa për punësim (aplikacioni);
- Dëshmi për shkollimin e noterizuar;
- Certifikata nga Gjykata Themelore në Prishtinë se nuk gjenden nën hetime apo për vepra të tjera.
- Certifikata e mjekut,
- Certifikata e Lindjes,
- Kopja e letërnjoftimit;
- Adresa e vendbanimit;
- Nr. i telefonit kontaktues si dhe
- E-maili kontaktues;

**V. Kualifikimet e nevojshme arsimore, aftësitë specifike dhe përvoja e punës**

- Diploma e noterizuar e kualifikimit fillor,
- Një (1) vjet përvojë pune në vendin e punës,
- Etikë profesionale dhe të jetë në gjendje të punoj nën presion;

**VI. Kohëzgjatja e emërimit:**

- Kontratë në kohë të caktuar si punë provuese prej 6 (gjashtë) muajve me mundësi vazhdimi.

**VII. Data e mbylljes së konkursit:**

- Konkursi është i hapur në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarik dhe atë nga data e publikimit.

**VIII. Mënyra se si merret dhe si dorëzohet formulari i aplikacionit për punësim:**

- Aplikacionet për punësim mund të merren fizikisht në zyrën e Departamentit të Administrimit Qendror dhe të njëjtat do të dorëzohen në arshivën e N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A. në Prishtinë si dhe mund të shkarkohet në web-faqën zyrtare/ [www.pallatirinise.com](http://www.pallatirinise.com) si dhe në facebook-un zyrtar/Pallati i Rinisë, duke klikuar paraprakisht/ like.

**IX. Afati i dorëzimit të aplikacioneve për punësim:**

- Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.